



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

ARJ nr.13/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konfliktin administrativ të paditësit, “P & C G” Sh.p.k, me seli në G., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florian Petani, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, (OSHP), me seli në P., “M”, si dhe të palëve të interesuara Komuna e Prishtinës, me seli në P, Rr. “UÇK”, nr.. dhe, OE “S” Sh.p.k me seli në K., Rr. “B.D”, nr..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Flamur Bllacaku, avokat në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit PSH.nr.144/23 të datës 19.04.2023, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, paraqitur përmes të autorizuarit të tij, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë,Kom.Dh.Sh.II.nr.1725/23 të datës 29.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18 Mars 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, “P & C G” Sh.p.k., me seli në G., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë,Kom.Dh.Sh.II.nr.1725/23 të datës 29.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë,Kom.Dh.Sh.II.nr.1725/23 të datës 29.12.2023, **APROVOHEN** si të bazuara ankesat e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, dhe palëve të interesuara Komuna e Prishtinës, me seli në P., dhe O.E. “S” SHPK me seli në K., **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.181/23 i datës 30.11.2023 ashtu që vendoset si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit “P & C G” Sh.P.K, me seli në G., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSh.nr.144/23 të datës 19.04.2023 të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, konform nenit 24.2 të LKA, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës

Komerciale, Kom.Dh.Shk.II.nr.1725/23 të datës 19.12.2023, në atë mënyrë që të: REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e të paditurit OSHP dhe ankesat e palëve të interesuara Komuna e Prishtinës dhe OE “S”, Shpk, të paraqitura kundër aktvendimit KA.Nr.181/23, të datës 30.11.2023 dhe VËRTETOHET aktvendimi KA.Nr.181/23 të datës 30.11.2023, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesa e paditësit “P & C G” Sh.p.k dhe është shtyrë ekzekutimi i vendimit të të paditurës PSH.nr.144/23, datë 19.04.2023, deri në vendosjen meritore mbi kërkesëpadinë e paditësit me aktgjykim të formës së prerë.

Përgjigje në kërkesë ka ushtruar pala e interesuar OE “S” Sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ushtruar nga paditësi dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë Kom.Dh.Shk.II.nr.1725/23, i datës 29.12.2023.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, përgjigje në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të dhomës së shkallës së dytë dhe atë dhomës së shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.181/23 të datës 19.12.2023, është vendosur: I. APROVOHET e bazuar kërkesa e paditësit “P& C G” Sh.p.k. II. SHTYHET ekzekutimi i vendimit PSH.nr.144/23 i datës 19.04.2023, i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për kërkesëpadinë. III. Caktohet seancë përgatitore me datë 20.12.2023 në ora 10:30.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera thekson se: Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që propozuesi e ka argumentuar me prova të besueshme faktin se ekzekutimi i vendimit do të sillte dëm i cili vështirë do të riparohet, se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, si dhe faktin se shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se pretendimi kryesor i paditësit “P & C G”, Sh.p.k, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar që rezulton me shkaktimin e dëmit të riparueshëm për paditësin, taksapaguesit dhe buxhetin e Komunës së Prishtinës është pretendimi se e paditura dhe autoriteti kontraktues kanë bërë shkelje të nenit 65 të Ligjit (Nr.04/L-042) për Prokurimin Publik në Republikës së Kosovës (LPP), duke shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik “S” Sh.p.k. për ndërtimin e rrugës A - pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5-1-2, Drejtori i të cilin është i dënuar për veprën penale Falsifikim i Dokumentit Zyrtar nga neni 398 par.2 të KPRK-së. Përkundër faktit të ditur për veprën e kryer, dhe njohurive se O “S”, ka nënshkruar deklaratën në betim mbi përshtatshmërinë me rastin e aplikimit për tender. Kërkesës për shtyrje ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Themelorë në Prishtinë, Departamentit për Krime të Rënda PKR. nr. 16/2018 të datës 30.03.2018.

Lidhur me këtë pretendim, gjykata e shkallës së parë vlerëson se në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit nr.04/1-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), neni 65 paragrafi 3, i cili përcakton se: *“Operatori Ekonomik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara; është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare”,* pretendimi i ngritur nga paditësi “P & C G” Sh.p.k, dhe i mbështetur në provë të besueshme Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.16/2018 të datës 30.03.2018, paraqet një çështje serioze që e vë në dyshim përshtatshmërinë e O “S” Sh.p.k, për ndërtimin e rrugës A - pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5.1-2. Gjykata vlerëson se është e domosdoshme që ky pretendim të sqarohet në procedurë gjyqësore në bazë të provave të administruara para realizimit të projektit. Sepse duke pas parasysh rëndësinë e vërtetimit të përshtatshmërisë së një operatori ekonomik për t’ia besuar realizimi e një projekti me vlerë prej 8,479,801.66 Euro, të financuar me paratë publike, pa u vërtetuar një pretendim i tillë kaq serioz, dëmi që do të shkaktohej është në çdo aspekt i riparueshëm dhe jo vetëm për paditësit, por e dëmton rëndë interesin publik sepse e vë në dyshim realizimin e tërë projektit.

Tutje theksohet se: Dëmi do të ishte vështirë i riparueshëm për paditësit-propozuesit sepse paditësi do të privohej nga e drejta për t’ju nënshtruar një procedure të ligjshme, transparente dhe pa diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomik në procesin e përzgjedhjes për realizim të aktivitetit të prokurimit. Në këtë mënyrë i njëjti nuk do të privohej vetëm nga përfitimet monetare por edhe nga mundësia e fitimit të përvojës profesionale në zhvillimin e aktivitetit të tij të rregullt ekonomik në një ambient ekonomik të besueshëm ku funksionon rendi publik dhe sundimi i ligjit. Dëmi do të ishte vështirë i riparueshëm edhe për O “S”, sepse i njëjti i ka filluar dhe i ka vazhduar punimet përkundër faktit që aktvendimet për masë të përkohshme - shtyrje të ekzekutimit nuk ishin bërë asnjë herë të plotfuqishme. O “S” ka vazhduar me implementimin e një kontrate të kontestueshme duke realizuar punime dhe duke marrë edhe obligime kontraktuale pa marrë parasysh faktin se lidhur me pretendimet që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e tij për realizimin e projektit është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore. Megjithatë, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar, gjykata vlerëson se vërtetimi i bazueshmërisë së pretendimeve në seancë gjyqësore, do ta vë të njëjtin në një pozitë më të sigurt në mënyrë që shpenzimet e bëra në realizimin e një kontrate të kontestueshme nuk do të jenë dëme vështirë të riparueshme dhe të pa kompenzueshme për të. Prandaj vendosja e masës së përkohshme është edhe në dobi të O “S”.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu vlerëson se shtyrja e përkohshme e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar dhe pezullimi i aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i Rrugës A - Pjesa e Parë”, me numër të prokurimit 616-22-7096-5-1-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, deri në shqyrtimin e pretendimeve të ngritura për shkeljet e pretenduara procedurale është më se i duhur që të ruhet interesi publik. Kjo po ashtu do të evitohet çfarëdo dyshimi për keqpërdorim të fondeve publike nga Autoriteti Kontraktues. Në të kundërtën realizimi i projekti para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor do të ndikonte negativisht në besimin e publikut lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike nga Autoriteti Kontraktues. Ndërsa, sqaron se shtyrja e përkohshme e aktivitetit të prokurimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk është as pengesë dhe as ndalesë për Ndërtimin e Rrugës A. Qëllimi i masës së përkohshme është pikërisht interesi publik në mënyrë

që të vërtetohet se operatori ekonomik-realizues i punimeve është i përshtatshëm dhe i besueshëm se punimet do të realizoj pa mashtrime, pa manipulime, duke përmbushur në përpikëri zotimet dhe duke vepruar nën përgjegjësi ligjore.

Në vazhdim theksohet se, gjykata e vlerëson ta pa pranueshëm pretendimin e O “S” se fitimi i humbur cilësohet dëm monetar i realizueshëm dhe i cili do të realizohej pa ndonjë vështirësi në rastet kur kemi të bëjmë me institucione shtetërore. Një arsyetim i tillë është i papranueshëm pikërisht për faktin se kemi të bëjmë me institucion shtetëror, sepse gjykata ka detyrim ligjor dhe kushtetues që të ushtroj kontroll gjyqësor ndaj vendimeve të organeve administrative për të garantuar ligjshmëri në aktivitetet e prokurimit që paguhen me fondet publike. Në mënyrë që të siguroj që nga fondet publike me veprime të kundërligjshme të mos paguhet dyfishi apo trefishi që do të duhej të paguhej për realizimin e një projekti.

Në fund theksohet se: Gjykata rikujton parimet themelore të afirmuara në nenin 1 të LPP-së, për shfrytëzim në mënyrë transparente, efikase dhe të drejtë të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke respektuar procedurat dhe detyrimet e përcaktuara nga të gjitha organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Parime këto fundamentale për mbrojtjen e interesit publik, për të siguruar përdorim të ligjshme të fondeve publike, mbrojtje të drejtave të operatorëve ekonomik dhe respektim të kushteve ligjore nga zyrtarët institucional.

Prandaj, nga kjo gjendje faktike e vërtetuar dhoma e shkallës së parë vlerëson se në mënyrë kumulative janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së, dhe duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), i aprovon si të bazuara ankesën e të paditurës OSHP dhe palëve të interesuara Komuna e Prishtinës dhe O.E “S” Sh.p.k me seli në K., ndryshon aktvendimin e shkallës së parë dhe refuzon kërkesën e paditësit “P & C G” Sh.p.k, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të OSHP-së. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga dhomat e shkallës së parë, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i dhomës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181, par.1 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, për shkak se aktvendimi i atakuar përmban të meta pasi që arsyet për faktet vendimtare janë të paqarta dhe kontradiktore.

Sipas vlerësimit të kolegjit të dhomës së shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë, nuk ka arritur të jep arsye bindëse për faktet vendimtare të cilat ndikojnë në zbatimin e drejtë të dispozitës së nenit 22 par.2 të LKA-së, duke mos balancuar drejtë kërkesën e palëve në raport me kriteret ligjore. Sipas vlerësimit të dhomës së shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, nëse analizohen një nga një kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, rezulton se dhoma e shkallës së parë fillimisht nuk ka arritur të jep arsye bindëse se ekzekutimi do

t'i sillte dëm paditësit, si kriter i parë ligjor nga neni 22 par.2 i LKA-së. Lidhur me dëmin eventual që do të pësonte paditësi, gjykata e shkallës së parë në arsyet e aktvendimit kontestues nuk ka arritur të konkretizojë dëmin potencial konkret për palën paditëse, por këtë e ka arsyetuar si dëmtim të interesit publik, sepse e vë në dyshim realizimin e projektit. Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, qëndrimin e tillë nuk mund ta pranojë si të drejtë, pasi që vlerësimi i dëmit sipas këtu kriteri duhet të kufizohet në dëmin që mund t'i shkaktohet vetëm palës paditëse. Në rastin konkret, duhet theksuar se pavarësisht epilogut përfundimtar të çështjes lidhur me aktin administrativ, pala paditëse nuk do të kishte mundësi ligjore të kontraktohej *a priori* për projektin që është objekt kontesti. Përkundër që paditësit mund t'i shkaktohet dëm eventual me lënien në fuqi të aktit administrativ, një gjë e tillë mund të riparohet përmes kompensimit adekuat si mundësi ligjore e palës në procesin administrativ. Në anën tjetër, vlerësimi i dëmit eventual të paditësit nuk mund të trajtohet në raport me dëmin e përgjithshëm si interes publik, pasi që interesi publik është kriter tjetër i veçantë.

Tutje theksohet se: Sa i përket vlerësimit të interesit publik si njëri prej kushteve ligjor nga neni 22 par.2 të LKA-së, gjykata ka tagër të shqyrtojë vetëm interesin publik në raport me objektin e shqyrtimit. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka lëshuar të përcaktojë drejtë se interesi publik nuk mund të trajtohet si çështje abstrakte në raport me besimin e publikut, por duhet të vlerësohet se kjo shtyrje e ekzekutimit të aktit a ka impakt në interesin publik. Rrjedhimisht, kolegji vlerëson se vlerësimi i këtij kriteri ndërlidhet me operimin e projektit për ndërtimin e rrugës A-pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5-1-2. Arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar për dëmin ndaj buxhetit, ndjekjen e procedurave në mënyrë transparente dhe evitimin e dyshimeve në proces, janë arsye përtej domenit të vlerësimit në këtë fazë të procedurës. Në këtë drejtim, kujdesi faktik ndaj aspekteve të përgjithshme buxhetore apo procedurale nën shqyrtimin *ex officio*, për gjykatën paraqet barrë të rëndë të të provuarit dhe një detyrim i tillë i takon vet autoritetit kontraktues gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit. Me hyrjen në procedurën e prokurimit dhe lidhjen e kontratës autoriteti i prokurimit merr cilësinë e palës kontraktuese dhe si palë në procedurë ka parashtruar ankesë, përfshirë edhe OSHP-në si organ administrativ.

Bazuar në vlerësimin e këtij kolegji, dhoma e shkallës së parë nuk ka arritur që të përcaktojë drejtë interesin publik, i cili në rastin konkret është i kufizuar në interesin për të vazhduar ose jo projektin që është objekt i procedurës së prokurimit, në raport me kërkesat e paditësit. Shqyrtimi i fakteve të tjera, siç është në rastin konkret buxheti, e tejkalon fushëveprimin e objektit të shqyrtimit dhe bie ndesh me kushtin tjetër që ndërlidhet me “dëmin e riparueshëm”. Gjykata e shkallës së parë në procedurat për shtyrjen e ekzekutimit të akteve administrative duhet që të trajtojë në mënyrë strikte vetëm kushtet nga neni 22 par.2 i LPK-së duke mos trajtuar aspektet që i takojnë çështjes së procedurës së konfliktit administrativ. Pikërisht për këtë arsye, LKA në nenin 22 par.2 ka parashikuar mundësitë që dëmi të riparohet, respektivisht që shtyrja të mos i sillte dëm palës kundërshtarë. Në rastin konkret, dhoma e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye dhe nuk e ka trajtuar dëmin eventual që shtyrja e ekzekutimit mund t'i sillte të paditurës dhe palëve të interesit. Në këtë drejtim, kolegji vlerëson se pikërisht shtyrja e vendimit jo vetëm se është në kundërshtim me interesin publik, po rrezikon që të dëmtojë më shumë palët e përfshira në raport me paditësin.

Dhoma e shkallës së dytë në lidhje me pretendimet e paditësit thekson se: Fillimisht, sa i takon pretendimit të paditësit për shpalljen eventuale si operator fitues, gjykata rithekson se trajtimi juridik i shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, kufizohet vetëm në dëmin eventual që mund t'i shkaktohet paditësit me ekzekutimin e aktit administrativ. Siç u theksua, gjykata pa paragjykuar

epilogun përfundimtar të çështjes dhe pasojave juridike që mund të sjell vendimi i gjykatës për ligjshmërinë e aktit administrativ, ekzistojnë të gjitha mundësitë që paditësi të kompensohet për çfarëdo dëmi eventual që mund të lind. Gjykata në këtë fazë të procedurës nuk mund t'i trajtojë pretendimet faktike që ndërlidhen me kontrollin e ligjshmërisë së aktit administrativ. Njëherit, nuk mund të trajtohen as pretendimet ankimore të OSHP lidhur me shkaqet e ankesës së operatorit ekonomik ankues nëpër fazat e procedurës së prokurimit. Po ashtu, gjykata nuk ka tagër të trajtojë as pretendimet ankimore të paditurve lidhur me veprimet e palëve në drejtim të përmbushjes së kushteve ligjore të dosjes së tenderit në raport me nenin 27 par.1 të LPP-së e as faktin se operatori ankues ka ofertuar me çmim më të lartë. Ndërkaq lidhur me pretendimet e rregullsisë apo aspekteve të brendshme të procedurës së prokurimit, përfshirë këtu pretendimet për kundërligjshmëri të shpalljes fitues të operatorit ekonomik për shkak të përfshirjes në vepër penale, është jokontestues fakti se në shkresat e lëndës ekziston aktgjykimi penal me të cilin vërtetohet se personi fizik N.S është i dënuar me vepër penale. Mirëpo, tani për tani, vlerësimi i provave konkrete në raport me ligjshmërinë e aktit administrativ i takon zgjidhjes së çështjes në merita dhe nuk bie në kuadër të shqyrtimit të kushteve ligjore nga neni 22 par.2 i LKA-së.

Tutje, kolegji i dhomave të shkallës së dytë thekson se, pa paragjykuar zgjidhjen meritore, edhe aktet juridike ndërkombëtare, përfshirë këtu Direktivën e Bashkimit Evropian për prokurimin publik 2014/24/BE, theksojnë se dënimi për mashtrim, korrupsion, vepra terroriste, pastrim parash ose pjesëmarrje në një organizate kriminale përbëjnë arsye të detyrueshme përjashtimi të një operatori ekonomik nga prokurimi publik. Për më tepër, e drejta për të zgjidhur kontratën është në dispozicion të Shteteve Anëtare nëse rezulton se një kontraktues ishte dënuar në një vendim përfundimtar për arsyet e renditura në nenin 57 § 1 të Direktivës në kohën e dhënies së kontratës. Direktiva, njashtu edhe rekomandimi i OECD-së për Prokurimin Publik (18 shkurt 2015), këshillon autoritetet e prokurimit t'i kushtojnë vëmendje parimit të proporcionalitetit në përdorimin e tyre të diskrecionit (Shih rastin e GJEDNJ, Kurban kundër Turqisë, aplikacioni nr.75414/10, Aktgjykimi i datës 19.04.2021, par.81). Ndërsa lidhur me masat preventive gjyqësore në procedurat e prokurimit, GJEDNJ thekson se *“autoritetet nuk duhet të pengohen të korrigjojnë gabimet e tyre, madje edhe ato që vijnë nga neglizhenca e tyre, sepse qëndrimi ndryshe do të ishte në kundërshtim me doktrinën e pasurimit të pabazë”* (Moskal kundër Polonisë, nr. 10373/05, parag. 73, aktgjykimi i datës 15 shtator 2009). *Për sa i përket çështjes në fjalë, i njëjti parim është njëlloj i vërtetë dhe Gjykata nuk vë në dyshim që autoriteteve të prokurimit mund t'u kërkohet të marrin masa që synojnë korrigjimin e gabimeve të tyre në interes të publikut. Megjithatë, parimi i përgjithshëm i mësipërm nuk mund të mbizotërojë në një situatë ku individit në fjalë i kërkohet të mbajë një barrë të tepërt”* (shih Kurban kundër Turqisë, aplikacioni nr. 75414/10, Aktgjykimi i datës 19.04.2021, par.82).

Nga të lartcekurat kolegji i dhomave të shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerëson se pretendimet e paditësit janë të pamjaftueshme në raport me kushtet ligjore nga neni 22 par.2 i LKA-së për tu aprovuar propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Ngase, ndryshe nga qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, andaj aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve në kërkesë, ekzaminimit të aktvendimit të kontestuar të dhomës së shkallës së dytë

dhe shkallës së parë të Gjykatës Komerciale si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, dhoma e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me aprovimin si të bazuar të ankesës së të paditurës OSHP dhe palëve të interesuara Komuna e Prishtinës dhe OE “S”. Sh.p.k., dhe ndryshimin e aktvendimit të dhomave të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së dytë në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë me që aktvendimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje të esenciale të dispozitave të procedurale nga neni 22 të LKA, dhe dispozitave të LPK-së, ashtu si pretendohet nga paditësit në kërkesë. Aktvendimi e kontestuar i dhomës së shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare dhe konkrete të vërtetuara sipas së cilave ka rezultuar se kërkesa-propozimi i paditësit “P & C G”. për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, të OSHP, PSH nr. 144/23 të datës 19.04.2023, është e pa bazuar.

Sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22 paragraf 6 të njëjtit ligj, përcaktohet se paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk ka arritur të dëshmoj me prova bindëse dhe konkrete mbështetjen e kërkesës së tij, fillimisht se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do ti shkactohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja-pezuillimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Pra në çështjen juridike konkrete paditësi, nuk ka paraqitur arsye bindëse për faktet vendimtare se cili është dëmi që i shkaktohet sipas kriterit të parë, a është dëmi potencial konkret i cili vështirë do të riparohej siç parashihen në nenin 22, të LKA-së, për deri sa në çështjen e ngritur me padi, pavarësisht epilogut përfundimtar të saj lidhur me ligjshmërinë e aktit të kontestuar me padi, si do që të vendoset në mënyrë meritore nuk provohet në mënyrë konkrete me argumente se paditësi do të pësonte dëm apo do të përfitonte apriori, sepse për tu kontraktuar i njëjti apo një Operator tjetër Ekonomik për aktivitetin e prokurimit në fjalë, duhet respektuar procedurat ligjore të konkurrimit të barabartë të gjithë operatorëve Ekonomik të cilat parashihen sipas Ligjit për Prokurimin Publik. Në këtë fazë të vendosjes për masë të përkohshme gjykata trajton në mënyrë strikte kushtet e parapara sipas nenit 22, të LKA e në veçanti kushtin e parë se cili është dëmi që i shkaktohet paditësit i cili vështirë do të riparohej nëse nuk shtyhet ekzekutimi i vendimit të kontestuar me padi deri në vendosjen meritore.

Pretendimet në kërkesë lidhur me shkaktimin e dëmit të riparueshëm, ku theksohet se: ky dëm derivon nga privimi i paditësit nga e drejta për të iu nënshtruar një procedure të ligjshme, transparente dhe pa diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomik në kuadër të procesit të përzgjedhjes për realizimin e aktivitetit të prokurimit, dhe meqenëse kompensimi i fitimit të humbur nuk është kërkuar deri në këtë stad të procedurës, sigurimi i kërkesëpadsisë do të ishte objektivisht i pamundur dhe i perealizueshëm, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson si të pa bazuara sepse nuk mbështeten me prova dhe fakte të argumentuara dhe konkrete, që paditësit i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej deri në

vendosjen meritore të çështjes, andaj si të tilla nuk janë qëndrueshme, janë pretendime të përgjithësuara dhe pa mbështetje në fakte të argumentuara në prova, në bazë të cilave do të dëshmohej se paditësit i shkaktohet dëm apo humbje e cila vështirë do të riparohet, përkatësisht për të cilat humbje dhe dëme shtyrja e ekzekutimit është e domosdoshme. Gjykata Supreme vlerëson se, si do që të vendoset çështja kryesore sipas padisë, do të jetë i mundur kompensimi sipas procedurave dhe mënyrave ligjore, ashtu që çfarëdo dëmi eventual që mund të pësojë paditësi do të jetë i riparueshëm, meqë bëhet fjalë për realizimin e projektit në vlerë monetare.

Pretendimet në kërkesë lidhur me interesin publik, ku theksohet se: dëmi që shkaktohet nga ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar nuk prek vetëm paditësin, por edhe taksapaguesit dhe buxhetin e Komunës së Prishtinës, me paratë e të cilëve është financuar projekti kapital për ndërtimin e rrugës A-pjesa e parë, është e pandershme, e papërgjegjshme dhe e kundërligjshme që qytetarët e Prishtinës ti paguajnë edhe 7 milionë euro të tjera një operatori ekonomik, potencialisht të papërgjegjshëm, mbi të cilin rëndon dyshimi i arsyeshëm se ka mashtruar në kuadër të procedurës së prokurimit publik, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara dhe të paqëndrueshme në raport e objektin e çështjes në shqyrtim, sepse gjykata në këtë fazë nuk ka tagër të vlerësojë çështjet që ndërlidhen me objektin e padis lidhur me vendosjen meritore të çështjes për deri sa kujdesin për koston e projektit dhe çështjeve buxhetore përkujdesjen në këtë drejtim e kanë organi i paditur, autoriteti kontraktues dhe organet tjera kompetente. Pretendimet lidhur me dëmtimin e interesit publik janë të mbështetura kryesisht në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur Organit Shqyrtues të Prokurimit, por që ligjshmëria e tij nuk shqyrtohet në këtë fazë të vendosjes, por në procedurë të rregullt gjatë vendosjes meritore të çështjes pas shqyrtimit të provave dhe fakteve sipas padisë së tij. Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate nuk provohet me prova konkrete dhe të argumentuara se shtyrja e vendimit të organit të paditur do të ishte në interes publik ashtu si pretendon paditësi, për deri sa fillimisht çështja duhet ndërlidhur me kushtin e parë dëmin e pa riparueshëm për paditësin.

Pretendimet në kërkesë lidhur me dëmin e mundshëm për palën kundërshtare përkatësisht personin e interesuar, ku theksohet se: duke marrë parasysh dyshimet e forta dhe të mirë argumentuara për mashtrim në prokurim publik, O., “S” „Sh.p.k, nuk pëson asnjë dëm të kundërligjshëm, sepse çdo cent që faturohet në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit konsiderohet potencialisht si dobi pasurore e kundërligjshme dhe produkt i veprës penale “*Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik*”, se as Komuna e Prishtinës dhe OSHP nuk pësojnë ndonjë dëm nga shtyrja e ekzekutimit të vendimit sepse mandati i tyre primar është mbrojtja e interesit publik, menaxhimi transparent, i drejtë, i ligjshëm i fondeve publike dhe jo favorizimi dhe mundësimi i pasurimit të kundërligjshëm të ndonjë operatori ekonomik, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara dhe të pa mbështetura në fakte dhe prova relevante që do të ndikonin në procedurë të vendosjes për masë të përkohshme ndryshe nga ajo e vendosur nga dhoma e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale si në aktvendimin e saj.

Pretendimet në kërkesë lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika n), neni 160 paragraf 4, dhe neni 175 të LPK-së, dhe se në aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, janë dhënë arsyetime të paqëndrueshme, të mangëta, të pamjaftueshme, kamufluese, jokoherente dhe kontradiktore, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara. Aktvendimi i dhomës së shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, është vendim i drejtë dhe ligjor, dhe i arsyetuar mjaftueshëm lidhur me



faktet vendimtare duke dhënë vlerësime përkatëse për pretendimet e paraqitura nga palët, ashtu siç parashihet në nenin 22 të LKA-së, për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit sipas provave të ofruara, gjithnjë duke u kujdesur që mënyra e vendosjes për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe arsyetimi i vendimmarrjes të mos e prejjudikoj mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore nga gjykata sipas padisë.

Gjykata Supreme i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe gjen se të njëjtat janë shqyrtuar nga dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, nga ka rezultuar me të drejtë se janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, andaj si të tilla edhe nga Gjykata Supreme refuzohen të pa bazuara dhe jo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur dhoma e shkallës së dytë, si në aktvendimin e saj, i cili rezulton se është i drejtë, ligjor dhe i arsyetuar mjaftueshëm, bazuar në faktet vendimtare sipas provave dhe fakteve të paraqitura nga palët, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes për masë të përkohshme, pa u prejjudikuar mënyra e vendosjes së çështjes kryesore.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ nr.13/2024, me datë 18 Mars 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani